



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 22.04.2016

Ref.: 236/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë, në mbledhjen e 41-të, të mbajtur më 14 prill 2016, mori:

V E N D I M

I. Zgjatet periudha e akreditimit për të gjitha programet e studimit të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" për periudhën një vjeçare, 1 tetor 2016 – 30 shtator 2017:

- Juridik, LLB (240 ECTS);
- Kontrata dhe e Drejta Komerciale / LLM (60 ECTS);
- E Drejta Penale / LLM (60 ECTS);
- E Drejta Kushtetuese Administrative / LLM (60 ECTS);
- E Drejta Financiare / LLM (60 ECTS);
- E Drejta Civile dhe e Pronës / LLM (60 ECTS);
- E Drejta Ndërkombëtare / LLM (60 ECTS);
- E Drejta Penale / PhD (180 ECTS);
- E Drejta Civile / PhD (180 ECTS);
- E Drejta Kushtetuese Administrative / PhD (180 ECTS);
- E Drejta Financiare / PhD (180 ECTS);
- E Drejta Ndërkombëtare / PhD (180 ECTS)

A r s y e t i m i

Duke u bazuar në nenin 15, pika 3 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës, dispozitat e tjera ligjore të cekura me sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti Juridik;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

Prof Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë